

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: **POLICIA E KOSOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **214-23-8647-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **FURNIZIM ME UNIFORME POLICORE**

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	<b>" EMPREUS " SH.P.K.</b>
NUI	<b>601636816</b>
Adresa	<b>Rr. Isa Kastrati</b>
Vendi	<b>Prishtine</b>
Kodi postar	<b>10000</b>
Numri Telefonit	<b>044717882</b>
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	<b>Donjetë Rexha</b>
Adresa elektronike	<b>empreuspr@gmail.com</b>
Data e parashtrimit të ankesës	<b>08.06.2025</b>

*\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

#### 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

Emri i avokatit  
Adresa e plotë  
Numri i Telefonit  
Numri i faks-it  
Adresa elektronike

#### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

#### **FURNIZIM ME UNIFORME TE STANDARDE POLICORE PER FEMRA DHE MESHKUJ**

**AK ka publikuar vendimin për anulim të procedurës me datë 19.05.2025. Ndërsa me datë 30.05.2025 AK ka publikuar vendimin për refuzimin e kërkesës tone për rishqyrtim.**

#### **4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet**

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

Po ☐

Jo ☒

#### **5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet**

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

Po ☒

Jo ☐

#### **6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve**

*A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

Po ☒

Jo ☐

*Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.*

**Ne kemi dorëzuar kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues me datë 26.05.2025, ndërsa Autoriteti Kontraktues ka refuzuar të njejtën me datë 30.05.2025.**

#### **7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Neni 7 - Barazia në trajtim/Jo-diskriminimi

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve  
Neni 99 - Funksionet dhe Kompetencat e OSHP  
Neni 104 - Parimet themelore  
Neni 105 - Kompetencat e OSHP-së  
Neni 107 - Rregullorja e procedurave të OSHP-së  
Neni 116 - Procedurat e vendim-marrjes  
Neni 108A - Zgjidhja preliminare e mosmarreveshjeve

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

## **8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Me datë 19.05.2025, në platformën e-prokurimi, kemi AK Policia e Kosovës ka publikuar njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit në fjalë.

Sipas këtij vendimi, AK anulon aktivitetin e prokurimit në mungesë të një oferte të përgjegjshme.

Në letren standarde për tenderuesin e eliminuar, AK ka njoftuar se oferta jone është e papërgjegjshme sipas vendimit të OSHP me numër 2024/0332 dhe 2024/0335 të datës 10.12.2024.

Me datë 26.05.2025, brenda afatit kohor, ne kemi dorëzuar kërkesë për rishqyrtim dhe e njëjta është refuzuar nga Autoriteti Kontraktues me datë 30.05.2025.

Me rastin e këtij vendimi, AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, pasi që ne na ka mohuar të drejtën e trajtimit të barabartë dhe jo-diskriminues në procesin e rivlerësimit.

OSHP ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së kur ka bërë konstatimin se oferta jone është e papërgjegjshme. Sipas Nenit 99, 104 dhe 105 të LPP-së ku përcaktohen kompetencat e OSHP-së, OSHP ka kompetencë të shqyrtojë ankesat nga palët e interesuara lidhur me shkeljet e mundshme të këtij ligji; mirepo askund në Ligjin e Prokurimit Publik, nuk është shprehur se OSHP ka të drejtë që konstatojë nëse një oferte e caktuar është e përgjegjshme apo jo. Kompetenca e OSHP-së është shqyrtimi i ankesave dhe i shkeljeve të mundshme të LPP-së, por në asnjë mënyrë vendim-marrja (vlerësimi) i ofertave.

Sipas Nenit 116 të LPP, Procedurat e Vendim-marrjes, paragrafi 6 është e shprehur qarte:

Një vendim i OSHP-së për ri-vlerësim të përzgjedhjes së ofertuesve ose dhënies së kontratës nuk nënkupton një ndryshim në rezultatin fillestar.

Ekzistojnë dhjetra raste ku OSHP ka marrë vendime të tilla, ku ka kthyer lenden në ri-vlerësim, e më pas për të njëjtin rast, me të njëjtat pale, ka refuzuar ankesat dhe ka lënë në fuqi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

*Si shembull është aktiviteti i prokurimit i zhvilluar nga Autoriteti Kontraktues Ministria e Punëve të Brendshme, me titull **Ndërtimi SHFMU në Pozharan - Komuna e Vitise vazhdimi i punimeve***” ku AK ka marrë vendimin për dhënie të kontratës. Kundrejt këtij vendimi ka pasur ankese në OSHP, ku më pas OSHP ka vendosur që t’i anulohet kete aktivitet të prokurimit, sipas vendimit të datës 17.01.2023 me numer 569 – 579/22. Sipas këtij vendimi “PSH lidhur me pretendimin ankimor konstaton se GOE i rekomanduar për kontratë sa i përket kërkesës së vendosur në DT për Grejderin 2-8 ton ka prezantuar një DUD doganor, i cili vlerësohet se nuk është conform kërkesës së dosjes së tenderit pasi që është me peshe 10 ton, andaj PSH kete pretendim ankimor e klasifikon sit e bazuar, se OE i rekomanduar nuk e plotëson atë dhe si i tillë e bënë të **papërgjegjshëm OE të rekomanduar** lidhur me kete aktivitet të prokurimit.”

AK më pas ka anuluar aktivitetin e prokurimit në pajtim me vendimin e OSHP, e kundër këtij vendimi OE i rekomanduar, ka shtruar ankese pranë OSHP, ku me datë 25.07.2023 në vendimin e OSHP me numer 2023/0074, është vendosur që ankesa të aprovohet pjesërisht, dhe lenda të kthehet në rivlerësim. Gjate rivlerësimit është shpallur perseri fitues OE i rekomanduar paraprakisht, e kundër këtij vendimi të AK ka pasur ankese në OSHP, e ku më pas OSHP me datë 22.01.2024 ka nxjerrë vendimin me numer 2023/0902 për refuzimin e ketyre ankesave, dhe mbetjen në fuqi të vendimit të AK.

*Pra, si përfundim, një OE ekonomik që OSHP e ka konsideruar të papërgjegjshëm në vendimin me numer 569 – 579/22, i njëjti institucion, e vendosë si të përgjegjshëm në vendimin me numer 2023/0902.*

Me rastin e vendimit për aktivitetin e prokurimit Furnizim me Uniforme Policore, Autoriteti Kontraktues në kundërshtim me dispozitat e LPP ka përdorur vendimin e OSHP për të mos vlerësuar fare ofertën të tij.

Në pajtim me rregullat e përgjithshme për zbatimin e vendimeve nga organet administrative, AK është i obliguar që të zbatojë dispozitivin e vendimit, e jo të përdorë detallet e arsytimit dhe të bëjë vlerësim në atë formë. Nëse oferta e tij është vlerësuar e papërgjegjshme nga OSHP, atëherë një gjë e tillë është dashur që të shprehet qartazi në dispozitiv të vendimit.

Me rastin e ri-vlerësimit, AK ka vepruar në kundërshtim me Nenin 7 – Barazia në Trajtim/Jo – Diskriminimi dhe Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve. Pra, Autoriteti Kontraktues është dashur që të veprojë në pajtim me dispozitat

e LPP, dhe te vleresoje oferten tone ne menyre te barabarte, sic ka vleresuar oferten tjeter, ne pajtim me Nenin 59 te LPP dhe Nenin 116, paragrafi 6:

Një vendim i OSHP-së për ri-vlerësim të përzgjedhjes së ofertuesve ose dhënies së kontratës nuk nënkupton një ndryshim në rezultatin fillestar.

Sa i perket ofertes se dorezuar nga DE Kosova Tekstil, ne konsiderojme se oferta e dorezuar eshte krejtesisht e papergjegjshme per arsyjet e meposhtme:

Në Aneksi 1 - SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME ne dosje te tenderit, **INFORMATAT E PËRGJITHSHME** paragrafi **Atestet** eshte specifikuar si vijon:

- Të gjitha materialet duhet të testohen në laboratore të akredituara dhe të certifikuara me ISO 17025:2005. Kjo duhet të dëshmohet me certifikatë. Ofertuesit duhet të përfshijnë në ofertën e tyre të gjitha raportet testuese si dhe certifikatën ISO 17025:2005 të laboratorit testues së bashku me fushëveprimin e certifikatës (në mënyrë që të dëshmohet se laborator në fjalë është i certifikuar për të bërë testimet e kërkuara)

Ne oferten e tyre, DE Kosova tekstil ka dorezuar raporte testuese (ateste) nga laborator Best SRL. Se bashku me oferten e tyre, DE Kosova tekstil ka dorezuar edhe nje dekarate nga laborator Best SRL, ku deklarohet se rezultatet te cilat kane simbolin § jane nenkontraktuar ne laboratore te tjera te akredituara. **(PROVA 1)**

Ne oferten e tyre, DE Kosova Tekstil ka dorezuar certifikaten e akreditimit me numer 1477L si dhe fusheveprimin e akreditimit te ketij laborator, ku mund te shihet se per cilat metoda testuese ka akreditim laborator Best SRL. **(PROVA 2)**

Sipas Certifikates se akreditimit ISO 17025 te laboratorit Best srl, laborator eshte I akredituar vetem per keto metoda testuse te cilat jane pjese e specifikacioneve teknike te kerkuara:

ISO 105-B02; ISO 1833; ISO 105-J03; ISO 105-D01; ISO 105-E04; ISO 105-E01; ISO 105-X12;

DE Kosova Tekstil ne oferten e tyre ka dorezuar edhe certifikata te akreditimit per dy laborator te tjere si dhe fusheveprimin e tyre:

- Brachi Testing Services Srl, certifikata me numer 0224L **(PROVA 3)**

- Centro Tessile Cotoniere e Abbigliamento SpA, certifikata me numer 033L **(PROVA 4)**

Avokati i autorizuar nga kompania jone ne lidhje me kete rast, ka kontaktuar me shkrim labororet Brachi Testing Services Srl dhe Centro Tessile Cotoniere e Abbigliamento SpA. Ne keto komunikime jane bashkangjitur edhe raportet testuese te dorezuara nga Best

Srl dhe nga labororet e “nenkontraktuar” eshte kerkuar qe te konfirmohet nese kane bere keto testime per Best Srl dhe nese i kane bere te njejtat, t’i percjellin rezultatet origjinale.

Me date 03.04.2025, avokati i autorizuar i kompanise tone ka pranuar një përgjigje zyrtare nga Centro Tessile Cottoniero e Abbigliamento S.p.A., respektivisht nga znj. Guiliana Miramonti, Menaxhere e Mbeshtjetjeve te Drejtperdrejta dhe Sherbime Teknike (ang: Technical Services and Direction Support Manager) e cila konfirmon se nuk kane bere asnjë testim per laboratorin Best S.r.l nga viti 2021 deri me tani. Nderkohe nese i analizojmë Atestet e dorëzuara nga OE DE Kosova Tekstil te gjitha janë te vitit 2023, nderkohe kemi konfirmim tanimë zyrtare se Centro Tessile Cottoniero e Abbigliamento S.p.A., nuk ka bere asnjë testim per laboratorin Best S.r.l nga viti 2021 deri me tani.

Si deshmi gjeni te bashkangjitur komunikimin mes avoktatit z. Editon Osmani dhe laboratorit Centro Tessile Cottoniero e Abbigliamento S.p.A. **(PROVA 6)**

Nderkaq me daten 24.04.2025, avokati i autorizuar nga kompania jone ka pranuar një përgjigje zyrtare nga Brachi Testing Services, respektivisht nga z. Massimo Ciofi, Drejtor i Operacioneve (ang: Operation Director) i cili konfirmon se nuk kane bere asnjë testim për laboratorin Best S.r.l nga viti 2020 deri me tani. Nderkohe nese i analizojmë Atestet e dorëzuara nga OE DE Kosova Tekstil te gjitha janë te vitit 2023, nderkohe kemi konfirmim tanimë zyrtare se Branchi Testing Services, nuk ka bere asnjë testim per laboratorin Best S.r.l nga viti 2020 deri me tani.

Prove: Komunikimi me e-mail i dt.19.03.2025 dhe dt.24.04.2025 ne mes meje Avokat Editon Osmani dhe z. Massimo Ciofi, Drejtor i Operacioneve (ang: Operation Director) pranë Branchi Testing Services, ku ne cc te korrespondencës është edhe agjencia e akreditimit. **(PROVA 7)**

Ne nderkohe, duke qene deshmitar te deklarave te rrejshme te ofertuesit dhe laboratorit Best Srl, ne kemi angazhuar nje zyre avokatie me seli ne Itali per te siguruar prova shtese lidhur me raportet testuse te dorezuara nga Best Srl ku i kemi kerkuar perseri laboratoreve Brachi Testing Services dhe Centro Tessile Cottoniero e Abbigliamento S.p.A. qe te konfirmojne nese kane bere raportet testuese te dorezuara nga Best Srl. Me date 19.05.2025, zyra e avokatise ne Itali ka pranuar nje konfirmim nga Presidenti i Laboratorit Brachi Testing Services, z. Giulio Lombardo, ku shkruan se konfirmojne pergjigjien e dates 24.04.2025 per avokatin Editon Osmani. Gjeni te bashkangjitur pergjigjien si prove. **(PROVA 8)**

Meqe Policia e Kosoves edhe ne komunikimet e tyre direkte ka pranuar konfirmim nga laboratorit Centro Tessile Cottoniero e Abbigliamento S.p.A. se nuk jane kryer testime per Best Srl, atehere nuk eshte dashur qe te pranoje asnje raport testues dhe asnje deklarate nga Best Srl, pasi qe ky laborator ka bere deklarata te rrejshme mbi vertetesine e raporteve testuese.

**Tek uniforma standarde e punes per Meshkuj dhe Femra eshte kerkuar:**

1. Materiali i kapeles:

- a. Cuklimi – ISO 12945 – Testimi eshte bere nga Best SRL (nuk eshte nenkontraktuar). Nga kerkimi me “search” ne dokumentin e fusheveprimit te laboratorit Best SRL, shihet qe kjo metode testuese

nuk mund te gjendet fare, qe nenkupton qe nuk ka akreditim per te.

Gjeni te bashkangjitur “screenshot” nga kerkimi i kesaj metode testuese ne dokumentin fusheveprimit te laboratorit Best SRL. **(PROVA 5)**

Gjeni te bashkangjitur atestin e dorezuar nga DE Kosova Tekstil per materialin e kapeles. **(PROVA 9)**

2. Materiali i astarit

- a. Cuklimi – ISO 12945 – Testimi eshte bere nga Best SRL dhe Best SRL nuk ka akreditim per kete metode testuese.

Gjeni te bashkangjitur atestin e dorezuar nga DE Kosova Tekstil per materialin e astarit. **(PROVA 10)**

Gjeni te bashkangjitur “screenshot” nga kerkimi i kesaj metode testuese ne dokumentin fusheveprimit te laboratorit Best SRL. **(PROVA 5)**

1. Kemisha me minge te shkurta:

- a. Cuklimi – ISO 12945 – Testimi eshte bere nga Best SRL (nuk eshte nenkontraktuar) dhe Best SRL nuk ka akreditim per kete metode testuese

Gjeni te bashkangjitur “screenshot” nga kerkimi i kesaj metode testuese ne dokumentin fusheveprimit te laboratorit Best SRL. **(PROVA 5)**

Gjeni te bashkangjitur atestin e dorezuar nga DE Kosova Tekstil per materialin e kemishes me minge te shkurta. **(PROVA 11)**

2. Kemisha me minge te gjata:

- a. Cuklimi – ISO 12945 – Testimi eshte bere nga Best SRL (nuk eshte nenkontraktuar) dhe Best SRL nuk ka akreditim per kete metode testuese

Gjeni te bashkangjitur “screenshot” nga kerkimi i kesaj metode testuese ne dokumentin fusheveprimit te laboratorit Best SRL. **(PROVA 5)**

Gjeni te bashkangjitur atestin e dorezuar nga DE Kosova Tekstil per materialin e kemishes me minge te gjata. **(PROVA 12)**

1. Pantallonat e Verës:

- a. Cuklimi – ISO 12945 – Testimi eshte bere nga Best SRL (nuk eshte nenkontraktuar) dhe Best SRL nuk ka akreditim per kete metode testuese

Gjeni te bashkangjitur “screenshot” nga kerkimi i kesaj metode testuese ne dokumentin fusheveprimit te laboratorit Best SRL. **(PROVA 5)**

- a. Vija e hekurit te pantallonave – eshte ofruar raport testues sipas metodes EN ISO 6330:2012 ISO 7769:2006, Testimi eshte bere nga Best SRL (nuk eshte nenkontraktuar) dhe Best SRL nuk ka akreditim per kete metode testuese

Gjeni te bashkangjitur “screenshot” nga kerkimi i kesaj metode testuese ne dokumentin fusheveprimit te laboratorit Best SRL **(PROVA 18)**

Gjeni te bashkangjitur atestin e dorezuar nga DE Kosova Tekstil per materialin e pantallonave te veres. **(PROVA 13)**

2. Pantallonat e Dimrit:

- a. Cuklimi – ISO 12945 – Testimi eshte bere nga Best SRL (nuk eshte nenkontraktuar) dhe Best SRL nuk ka akreditim per kete metode testuese

Gjeni te bashkangjitur “screenshot” nga kerkimi i kesaj metode testuese ne dokumentin fusheveprimit te laboratorit Best SRL. **(PROVA 5)**

- b. Vija e hekurit te pantallonave – eshte ofruar raport testues sipas metodes EN ISO 6330:2012 ISO 7769:2006. Testimi eshte bere nga Best SRL (nuk eshte nenkontraktuar) dhe Best SRL nuk ka akreditim per kete metode testuese

Gjeni te bashkangjitur “screenshot” nga kerkimi i kesaj metode testuese ne dokumentin fusheveprimit te laboratorit Best SRL **(PROVA 18)**

Gjeni te bashkangjitur atestin e dorezuar nga DE Kosova Tekstil per materialin e pantallonave te dimrit. **(PROVA 14)**

Gjeni te bashkangjitur atestin e dorezuar nga DE Kosova Tekstil per vijen e hekurit. **(PROVA 15)**

1. Kravata:

- a. Cuklimi – ISO 12945 – Testimi eshte bere nga Best SRL dhe Best SRL nuk ka akreditim per kete metode testuese

Gjeni te bashkangjitur “screenshot” nga kerkimi i kesaj metode testuese ne dokumentin fusheveprimit te laboratorit Best SRL. **(PROVA 5)**

Gjeni te bashkangjitur atestin e dorezuar nga DE Kosova Tekstil per materialin e kravates. **(PROVA 16)**

1. Xhemperi:

- a. Cuklimi – ISO 12945 – Testimi eshte bere nga Best SRL dhe Best



SRL nuk ka akreditim per kete metode testuese

Gjeni te bashkangjitur “screenshot” nga kerkimi i kesaj metode testuese ne dokumentin fusheveprimit te laboratorit Best SRL. **(PROVA 5)**

Gjeni te bashkangjitur atestin e dorezuar nga DE Kosova Tekstil per materialin e xhemperit. **(PROVA 17)**

Me poshte mund te gjeni linkun e certifikatave te akreditimit per laboratorin Best Srl:

- Best Srl

<https://certificati.accredia.it/lab/85c7c6c7a0d353cdfbb00e55f2e738fe/A>

Ne jemi te bindur se OSHP nuk eshte informuar drejte mbi vleresimin dhe pretendimet ankimore me rastin e nxjerrjes se vendimit me numer 2024/0332 dhe 2024/0335 te dates 10.12.2024. Ne kerkojme nga OSHP qe me rastin e shqyrtimit te ankeses tone te vendose eksperte te fushes qe e kuptojne drejte kete aktivitet te prokurimit, e qe do te ishte shume e nevojshme per vendim-marje te drejte. Permes kesaj ankese, ne kerkojme nga Organi Shqyrtues i Prokurimit qe te pranoje ankesen tone si te bazuar, dhe te ktheje lenden ne rivleresim.

## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**Fitimi i humbur per kete kontrate.**

**Demtimi i reputacionit.**

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*